



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal of Kacanik

01Nr. 60/01-13696/22  
Kaçanik, 31.05.2022

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **V (pestë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2022 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 31 maj 2022. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 27 anëtarë-të gjithë.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkyetari i Komunës-Sabedin Vishi, Drejtori e drejtive: Qamil Stagova-DUKMM, Dardana Tafili-Dauti-DAP, Hafize Sallahi-DKRS, Sali Malsiu-DSHMS, Ramadush Osmani-DSHPE, Zahir Doda-DA, Suhad Dullovi-DBPZHR, ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishin: Fatlume Guri-Selimi, Bejtulla Dalloshi, Arbnora Kuka, Festim Neziraj.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Telprezencës nga Gëzim Sahiti-zyrtarë i lartë për monitorim të komunave në MAPL.

Mbledhjen e kryesoit Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit,  
Procesmbajtëse Makfire Malsiu.

**Kryesuesi i Kuvendit z. Kemal Murseli:** Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu pëershëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, fillimisht bëri një njoftim për anëtarët e KK për organizimin e një mbledhje Solemne për nderë të 11 Qershorit-Ditës së Çlirimtë Komunës së Kaçanikut. Jam duke menduar që nëse ka mundësi me na krijuar kushte, me mbajtur mbledhjen solemne të Kulla e Hasanit-shtëpia simbol i rezistencës së luftës së UÇK. Kërkoj nga shefat e GP me dhënë mendimin e tyre.

**z. Agim Mani:** Në emër të LVV do të japim mendimin pasi të konsultohemi me subjektin tonë politik.

**znj. Arditra Rrahmani:** Në emër të LDK konfirmoj se pajtohem me propozimin e kryesuesit të KK.

**z. Ekrem Livoreka:** Në emër të AAK konfirmoj se pajtohem me propozimin e kryesuesit të KK.

**z. Rrustem Zenuni:** Në emër të PDK konfirmoj se pajtohem me propozimin e kryesuesit të KK.

**z. Agim Çaka:** NISMA konfirmoj se pajtohet me propozimin e kryesuesit të KK.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Lidhur me mbledhjen solemne, mbetet LVV të konfirmoj vendimin e tyre, atëherë konstatoj pjesëmarrjen duke i thirrur emër për emër, kushte pune me u mbajt

mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e V (pestë) të rregullt të kuvendit të komunës për vitin 2022, data 31 maj, me këtë:

### **REND PUNE**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e kuvendit të komunës;
2. Draft-Rregullore për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës sportive në komunën e Kaçanikut;
3. Programi komunal trevjeçar i banimit për vitet 2022-2025;
4. Plani komunal për integritet 2022-2026;
5. Propozim-Vendimi për ndryshimin e thirrjes, Shkolla e Mesme Profesionale –ShMP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”, Institucion i Arsimit dhe Aftësimit Profesional - IAAP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”;
6. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes  $300m^2$  në parcelën kadastrale 00255-3 zona kadastrale Vatë-Dubravë, me kulturë bujqësore Arë e klasës 5, në emër të Xhevxhet (Ahmet) Mema nga f. Dubravë;
7. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes  $300m^2$  në parcelën kadastrale 00311-0 zona kadastrale Ivajë, me kulturë bujqësore Livadh i klasës së 6, pronë e Samedin (Vehbi) Rexha nga Kaçaniku.

Lidhur me Rendin e propozuar të punës e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

### **APROVON**

**Rendin e punës në përbërje prej 7 pikave.**

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka lë të urdhëroj: Për vërejtje nuk u paraqit kush, atëherë Procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KK e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

### **APROVON**

**Procesverbalin e mbledhjes së Kuvendit të Komunës e datës 29.04.2022 / Lënda: 01Nr. 60/01-11080/22.**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kalojmë në pozicionin e pyetjeve dhe kërkesave;

**Pyetje dhe Kërkesa**

**znj. Ardit Rrahmani:** Rruga “Malsor Dashi” është rrugë mjaft e qarkulluar- rrugë lidhëse mes Kaçanikut dhe f. Stagovë, e cila rrugë na dërgon të varrezat e reja të qytetit. Kjo rrugë përpos mungesës së trotuarit, ka edhe mungesë të ndriçimit publik. Qarkullimi në atë pjesë sidomos në sezonin e verës është shumë i konsiderueshëm, ku edhe një numër i madh i qytetarëve e shohin atë pjesë të qytetit si mundësi e mirë për rekreacion dhe ecje. Deri kur ajo pjesë e qytetit do të jetë në atë gjendje dhe a keni menduar me marrë veprime të nevojshme për rregullimin e ndriçimit publik dhe të trotuarit të asaj rruge?

**z. Betim Shala:** Unë kisha kërkuar nga DUKMM dhe nga Kryetari i Komunës që në këtë vit në kuadër të projekteve të ndërtimit të rrugëve lokale me u përshirë edhe rruga: “Sylejman Kuka”.

**znj. Kadrije Lika-Troni:**

1. Unë kam një pyetje lidhur me disa mjete të punës që janë shpërndarë për përfituesit e fermerëve, ku në kuadër të këtij konkursi apo thirrje për aplikim është formuar një komision, këtu kam hasur në një gjetje, ku të një prej përfituesve – përfitues i makinës shpërndarëse të plehut mineral, nuk figuron nënshkrimi i njërit nga anëtarët e komisionit. Kjo lënë hapësirë me dyshuar pse nuk ka nënshkruar njëri nga anëtarët e komisionit.

2. Lidhur me dy pyetje të cilat i kam ngritur, në mbledhje të KK nuk kam marrë përgjigje. Unë kam pritur me marrë përgjigje me shkrim, janë vonuar përgjigjet që dy muaj, nuk e di arsyen pse po vonohen përgjigjet kaq shumë?

**z. Naim Beça:** Kam dy pyetje dhe një kërkesë:

1. Kërkesa i adresohet Kryetarit të komunës si udhëheqës i KKSB, ashtu që për mbledhjen e radhës të kuvendit, t’na raportoj për bashkëpunimin që e ka me inteligjencën e Policisë së Kosovës në komunën e Kaçanikut. A jeni në dijeni, sa është numri i njerëzve që konsumojnë hashashin, drogën apo substancat narkotike, të cilat janë brengë e madhe për qytetarët e Kaçanikut? Për këtë çështje të bëjmë një temë tjetër për mbledhjen vijuese, sa persona janë arrestuar që janë konsumues apo shpërndarës të substancave narkotike apo dukurive tjera negative.

Si është e mundur që vetëm në komunën tonë, fëmijëve ju shërbejnë pije alkoolike. Unë kam qenë dëshmitarë para 2-3 ditëve, ku i kam parë fëmijët e moshës 15-16 vjeçare duke u shëtitur në shëtitoren e qytetit në gjendje të dehur. A ka ndonjë masë, a është dënuar ndokush për këtë. Unë e di se na vjen raporti i KKSB, por mundësish me marrëveshje t’na informoj sadopak kryetari sesa adoleshentë pinë drogë. Secili nga ne këtu e dimë, por nuk e shprehim se edhe në shkolla fillore pihet hashashi dhe shihen cigare në tualete të shkollave fillore e mos të flas për shkolla të mesme. Po ashtu është brengë e madhe informata se, nxënësit në shkolla të mesme mbajnë me veti thika, revole, boksa të hekurit etj. Kjo është një brengë shumë e madhe, brenga numër një dhe krejt jemi dëshmitarë për këto dukuri.

2. Çështja e rrugëve në Kaçanik, është bërë bajat kjo punë, prej shtatorit të vitit 2021 nuk mundesh me bërë një shëtitje nëpër qendër të qytetit të Kaçanikut. Para xhamisë, kockat-kubzat janë hapur, tani besoj se do të hapen edhe më tepër, është krijuar një gropë e madhe, jam i bindur se brenda javës ka me pasur edhe me tepër prishje të kubzave në atë pjesë. Kërkoi me intervenuar në çështjen e rregullimit - mbulimit të asaj grope. Po ashtu para barnatores të Ura e Hazirit, është krijuar një gropë shumë e madhe. Njerëzit me vullnet të mirë po e mbulojnë atë gropë me paletë. Kjo rrugë është e frekuentuar, ndërkaq nuk kushton shumë mbulimi i asaj grope.

3. Çështjen e shkallëve të banesa në rrugën “Skënderbeu” të cilën e kam potencuar në mbledhjen e kaluar, a mundet komuna me i rregulluar apo jo ato shkallë ?

**z. Agim Çaka:** Unë desha me ngrit një çështje e cila u ngrit edhe tani në këtë mbledhje, për shqetësimet, pyetje dhe kërkesat të cilat po i parashtojm, nuk kemi marrë përgjigje në shumicën prej tyre. Në 4 mbledhje, janë ngritur shumë pyetje dhe kërkesa, ndërkaq unë nga të gjitha pyetjet dhe kërkesat që i kam ngritur, kam marrë vetëm 2 përgjigje. Besoj se për 4 mbledhje i kam ngritur diku 12 çështje. Duhet ta rregullojmë këtë çështje, ose t ‘na jepën aty për aty përgjigje për ato pyetje dhe kërkesa që munden me na u dhënë, ndërkaq për ato që kerkohen dokumentacion, përgjigjet na jepen me vonë. Unë konkretisht e kam ngritur: Çështjen e mbeturinave; Stazën për këmbësor dhe ndriçimin në f. Bob; Ndotjen e lumbit Neredime; Çështjen e kalasë së qytetit: Ujësjellësit dhe rezervarët e kështu me radhë dhe nuk kemi përgjigje në asnijëren prej këtyre. Është mirë që mos t’i kalojmë këto çështje që i ngritëm shkel e shko, se këto janë shqetësime të qytetarëve të komunës, në mënyrë që ta dimë a ka me u bërë, fjala vjen staza apo jo, a ka me u rregulluar çështja e lumbit neredime apo jo, pastaj çështja e sallës së KK, a do të bëhet salla me funksionale apo jo. Çështjet e ngritura janë disa tema shqetësuese, ndërkaq nuk kemi marrë përgjigje.

2. Me intereson çështja e zërimit, sa paguan zërim komuna, e ka të caktuar pagesën për zërim komuna, a është vlerë vjetore apo bëhet me kontratë ? Sepse sa jam në dijeni që sa vjet paguhet zërimi, ndërkaq me ato mjete mundet me u sigurua një teknikë e mirë e zërimit e cila mundet me qëndruar në shtëpinë e kulturës, ndërkaq mundet me u shfrytëzuar edhe për nevoja të komunës.

3. Kam një pyetje lidhur me kioskat ambulatore që po vendosen në bulevard. A ka ndonjë projekt komuna, apo kujt ti teket me vendosur aty kioskë pa ma parasysh formën, hapësirën, biznesin të cilin e zhvillon aty ? Mendoj se komuna duhet me pasur një projekt dhe ku mund të vendosen kioskat. Kjo kishte me qenë mirë për syrin e qytetarëve renditja e tyre për pamjen, për dukjen dhe për sy të qytetarëve dhe për bizneset që zhvillohen aty, e jo me u vendosur kioske në formë të çrrgullt, por me rend dhe rregull. Pyetja është; A ka projekt komuna, sa kioske do të vendosen në total, hapësirat e vendosjes se tyre në bulevard, apo vendosen në bazë të kërkesave që parashtron, se pastaj ajo formë bien keq në sy të qytetarëve dhe lind nevoja për heqjen e tyre ?

**z. Naim Beça:** Shprehi shqetësimin e qytetarëve të komunës për çështjen e reshetave në rrugë, të cilat me rastin e kalimit të veturave, janë shumë të zhurmshme,, e ne veçanti në orët e vonshme të natës. Qytetarët me janë lutur me biseduar me kryetarin për këtë çështje. Problemi është të rruga përpjetë kah Rakoci, pastaj në rrugën Nexhmush Elezi. Është kërkesë e qytetarëve, i kam edhe nënshkrimet e qytetarëve, me rregulluar këtë çështje, se është shumë problem i madh, me çka mund të ketë edhe pasoja.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Pyetje e Kërkesa tjera nuk ka, kalojmë në pikën e dytë:

2. Draft-Rregullore për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës sportive në komunën e Kaçanikut;

Materialin e keni marrë, rregullorja iu ka nënshtruar diskutimit publik, besoj se janë përfshirë propozimet nga debati publik. Fjalën fillimisht e ka drejtoresha, pastaj e hapi diskutimin:

**z. Hafize Sallahi:** Kjo rregullore është punuar nga 7 anëtarë të komisionit të cilët kanë bërë me të mirën e mundshme se si të shfrytëzohet palestra sportive. Me 19 maj ka qenë drafti në diskutim publik, ku kemi pasur një numër të konsiderueshëm, propozimet e debatit janë futur në rregullore. Kjo rregullore përfunksionim të palestrës e ka në planifikim mirëmbajtën, të drejtën përfshyrëzim, kërkesat përfshyrëzim, orarin e funksionimit, rregullat themelore, vendosjen e reklamave etj.

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin e kësaj pike:

**z. Agim Mani:** Është mirë që kemi arritur në këtë pikë me pasur rregullore përfalestrën sportive. Duhet falenderuar ministrin e kulturës së qeverisë aktuale që pas shumë kohe, ka arritur të përshpejtoj procedurat dhe të bëjë përvimin e palestrës sportive. Uroj që palestra sportive të jenë në shërbim të gjithë qytetarëve të komunës, mirëpo përfshyrëzuar normalisht se duhet vendosen rregulla. Andaj kërkoj që këto rregulla të zbatohen me përkushtim me të madh nga drejtoresha e kulturës, rinisë dhe sportit e cila vet i ka vendosur këto rregulla. Në emër të LVV konfirmoj do të jemi Përmiratimin e kësaj rregulloreje.

**z. Ardit Rrahmani:** Ne po miratojmë rregullore përfshyrëzim të palestrës sportive, por pa emër. Me intereson të di, kur do të bëhet emërtimi i palestrës sportive?

**z. Hafize Sallahi:** Po e nderuar Arditë, jemi në formim të komisionit përfshyrëzimi i palestrës sportive, do të ketë edhe debat publik me qytetarë. Kemi marrë disa propozime dhe jemi në përgatitje të formimit të komisionit, se shpejti do të bëhet emërtimi i palestrës sportive.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim përfshyrëzim i rregulloren dhe e njëjta u aprova njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori vendim me të cilin e,

#### APROVON

**Rregulloren përfshyrëzim të palestrës sportive në komunën e Kaçanikut / Lënda:** 01Nr. 09-104/02-13257/22.

3. Programi komunal trevjeçar i banimit përvitet 2022-2025;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Materialin e keni marrë, drejtori është këtu, para se me hapur diskutimin, fjalën e ka drejtori, Sali Malsiu.

**z. Sali Malsiu:** Unë fillimisht po u jap një sqarim përfshyrëzim i cili është bërë tek numri i familjeve që jetojnë me asistencë sociale, periudha është 2015-2018, në fakt duhet të jetë 2019-2022 dhe numri i familjeve që kanë përfshitur. Përmirësimin e kam bërë dhe ua kam përcjellë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin e kësaj pike:

**z. Adnan Reka:** Para disa viteve e kishim një program të tillë trevjeçar të banimit social, 2018-2021. Ai program siç e dimë nuk është realizuar, edhe pse janë shpenzuar mbi 600.000€ përvitet 24 banesa. Pse duhet të besojmë ne që një program i tillë do të realizohet, kur ende programi i parë nuk është realizuar. Unë mendoj se është jo serioze me sjellë programe të banimit social, ende pa u realizuar programi paraprak.

**z. Agim Mani:** Në këtë program trevjeçar të banimit, komisioni prej 5 anëtarëve i cili e ka hartuar programin, pretendon se në këtë program i ka paraqitur kërkesat e qytetarëve në nevojë, 120 është numri i kërkesave për banim. Komuna janë në programin trevjeçar nuk ka arritur t'iu siguroj asnjë qytetari banim. Siç e dimë tani është viti i 5-të, ndërkaq ende nuk janë lëshuar 24 banesat e banimit social. Nëse vazhdojmë me këtë trend, atëherë këto kërkesa nuk mund të realizohen për 10 vite. Ne këtë program nuk është përmendur një kategori shumë e ndieshme, familjet e dëshmorëve. Një pjesë e këtyre familjeve të cilët jetojnë në disa banesa, ende nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit të përhershme të tyre në ato banesa ku jetojnë. Në bazë të shifrave, është shqetësuese numri i të papunësuarve në Kaçanik me numër 7607 të papunë të paraqitur si në tabelë. Nëse e shikojmë me përqindje, i vjen gati 50% të papunë nga mosha 18-65vjeçare. Ky program nuk është bërë në formë profesionale, sepse ka gabime kundërthënëse mes veti. p. sh. të mërgata, personat që janë në mërgatë thuhet së janë 6795, kjo nuk përkon me realitetin. Kjo shifër kur është kalkuluar me përqindje ka dal 17.1 %. Nëse këtë shumë e kalkulojmë del mbi 20%. ndoshta janë gabime teknike apo pakujdesi rrithë përpilimit të këtij programi. Numri i atyre që marrin asistencë sociale, nga viti 2015-2021, të bënë me kuptuar se nuk është përmirësuar gjendja e qytetarëve.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Të programi trevjeçar i banimit është dashur të ceket një strehimore për dhunën në familje. Ne si komunë duhet të kemi një objekt për strehimin e personave që përjetojnë dhunë në familje si strehim për fëmijë etj. Ne e kuptuam se ishte një strehimore në nivel regional në Ferizaj, mirëpo unë mendoj që në këtë program është dashur me u paraparë një strehimore për këtë kategori.

**z. Agim Mani:** Të banimet kolektive, nuk e di nëse është gabim teknik, drejtori duhet me dhënë përgjigje, thuhet se objekte janë 22, ndërsa banesa 671 të banimi kolektiv para 99 dhe pas vitit 99.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Objekt dhe banesa dallojnë, objekti është ndërtesa. Nëse janë 22 objekte, mundet me qenë 671 banesa në kuadër të tyre, se duhet dalluar objektin si objekt dhe banesat. Një objekt mundet me i pasur 100 banesa.

**z. Agim Çaka:** Të popullsia, është paraqitur numri banorëve sipas moshave, ndërkaq të nataliteti thuhet se nuk ka të dhëna zyrtare për natalitet. Mungesa e të dhënave të natalitetit është bukur shqetësuese, se duhet me i pasur të dhënat sa kanë lindur dhe sa kanë vdekur, se nuk është në rregull mos me pasur të dhëna fare. Ata të cilët e kanë punuar këtë program,, duhet të kenë të qartë së ky program pa këto të dhëna po del jo i kompletar.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ne këto çështje i kemi trajtuar edhe në KPF, dokumenti iu ka ofruar drejtorit nga komisioni, kur të vjen puna e shifrave, duhet ditur edhe burimi i të dhënave. Sigurisht këto të dhëna, janë nga institucionet përkatëse, enti i statistikave apo registrat e gjendjes civile, ashtu si e tha edhe Agimi. Ne e dimë së të dhënat nuk janë si në letër përmërgimtarë, se numri është më i madh, por burimi i të dhënave janë marrë në formë zyrtare nga institucionet përkatëse. Ne këtë problem e kemi edhe në zgjedhjet lokale, se numri i zgjedhësve po na del i barabartë me numrin e banorëve, e që nuk është real. Si do që të jetë këto të dhëna ekzistojnë në institucionet përkatëse dhe ne nuk mund të dalim me shifra tjera, se nuk jemi kompetent për atë çështje. Çështja e natalitetit është keq që nuk figuron, por sigurisht kur janë kërkuar të dhënat, nuk kanë pasur informacion dhe ka dalë plani pa këto të dhëna.

**z. Sali Malsiu:** Pyetja ishte pak sa provokuese, sepse programi i banimit social 2018-2021 është në realizim e sipër.

**z. Adnan Reka:** Pse duhet ne të besojmë ne se do të realizohet programi i dytë, kur nuk është realizuar programi i parë deri 2021, ku janë shpenzuar mbi 600.000€, ndërkaq banesa sociale, e cila i ka kaluar të gjitha afatet e realizimit dhe nuk është realizuar. Ajo ndërtësë ishte dashur me u realizuar në vitin 2017. Nuk është realizuar një ndërtësë, ndërsa ne po flasim për një program, e që e dimë që është vështirë me u realizuar.

**z. Sali Malsiu:** Duhet me besuar në realizimin e këtij programi, se u realizua programi i parë, tani do të realizohet edhe programi i dytë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Mos të shndërrojmë debatin në bashkëbisedim. Shqetësimet besoj se janë me vend, ndërkaq çështja se e ka sjellë drejtori një program në KK nuk është gabim. Planet, rregulloret miratohen në KK, ndërkaq sosa realizohet ai plan, raporton ekzekutivi në KK, janë raportet të cilat i shohim sosa zbatohen. Nuk është faji i komunës që nuk është realizuar ende projekti i banimit social, ai projekt është financuar nga ministria në bashkëpunim me komunën, janë ata që e kanë zvarritur procesin. Ne i dimë projektet me bashkëfinancim se ku ngecin, Agimi me shumë ende e lavdëroj ministrin për përvimin e palestrës, meqë është ende ai ministër, me ndikuar me na sjellë edhe projekte të reja, e duartrokasim. Është mirë që kjo qeveri mos me i penguar kreditë ndërkombëtare që ka pasur komuna e Ferizajt se jemi duke e pësuar ne komuna e Kaçanikut për çështjen e ujërave të zeza, që është shqetësim që po ngritet gati në çdo mbledhje. Tani është bërë alarmante kjo në qeveri, nuk nënshkruhet marrëveshja me shtetin hungarez, për shkak të kredisë që ka paraparë me marrë komuna e Ferizajt, për me trajtuar çështjen e hedhjes së ujerave të zeza në lumin neredime. Ne të gjithë bashkërisht, edhe ju opozita është mirë me ushtruar ndikimin e juaj, që projektet që janë për Kaçanikun me i shtyrë përpara. Neve na keni përballë, asnjëherë nuk e pengojmë atë punë, edhe pse të palestra, ne e dimë se qysh jemi akuzuar për vendimin që e kemi marrë, megjithatë është bërë një projekt i mirë, dhe duhet ta shfrytëzojmë të gjithë. Secili projekt nga kushdo që vjen, pa i dhënë ngjyrime politike duhet të përkrahim, e jo të bëhem pengesë.

**z. Adnan Reka:** Agimi me të drejtë e tha, por juve iu kisha sugjeruar me u marrë me qeveritë e juaja, e jo për qeverinë aktuale që i ka bërë një vjet. Unë nuk ta kam ndier asnjëherë zërin pse nuk po ndërtohet palestra sportive. Është dashur me ngritur çështjen e ndërtimit të palestrës sportive, por edhe çështjen e banesës sociale, pse nuk janë realizuar deri sot, e jo atë strumbullarin e projekteve të pakryera, punëve të pakryera për arsyet e ndryshme, tani pritni me ua realizuar me shkop magjik kjo qeveri, jo nuk mundet.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Meqë mu drejtovë mua edhe pse nuk ta përmenda emrin, unë e kam ngritur këtë çështje sa herë. E dyta, kam qenë pjesë e vendimit kur është miratuar vendimi për palestër sportive, dhe për këtë jemi akuzuar shumë. Besoj se tani jeni pajtuar edhe ju se ka qenë në rregull, me vjen mirë për këtë. Mua nuk me ka penguar përvimi i palestrës sportive, por palestra sportive është mëritë edhe e shumë ministrave para ministrit aktual të kulturës, kështu që, është mirë të trajtojmë problemin në përgjithësi e jo vetëm në një aspekt.

**z. Naim Beça:** Janë 2 çështje këtu 1. Qeveria udhëhiqet nga LVV. Gjatë zgjedhjeve lokale nuk ka dalë asnjëri nga ne këtu me u lavdëruar për çështjen e mbeturinave, rregullimin e shtratit të lunit, por ka dalë kryetari i Ferizajt, ndërkaq pasojat po i bartim ne. Kjo nuk ka koment! Të e rregullon këtë çështje kryetari i Ferizajt, se ka dalë në Ferizaj dhe ka premtuar

realizimin e këtyre projekteve, ai të raporton realizimin e tyre, përndryshe komuna jonë ka të drejtë me i bërë padi.

2. Çështja që po thoni se jemi pajtuar për ndërtimit të palestrës sportive, kurrë Kaçaniku me fikshat që unë kam qenë udhëheqës i tyre nuk pajtohem që është hequr nga aty stadiumi i futbollit “Besnik Begunca”, e është ndërtuar palestra sportive aty. Kushdo që e ka votuar, ne nuk jemi pajtuar, ne kemi qenë në mbledhje këtu, unë kam ardhur nga Katarit me folur për këtë çështje edhe e kemi kundërshtuar, mos mendoni se jemi pajtuar dhe asnjëherë nuk pajtohem.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjtë u aprovua me 18 votë Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 9 anëtarë (8 anëtarët nga LVV dhe anëtarët nga NISMA). Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për Aprovimin e Programit komunal trevjeçar i banimit për vitet 2022-2025 / Lënda: 01Nr. 104/02-13207/22.**

4. Plani komunal për integritet 2022-2026;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Drejtoresha është këtu, fillimisht ia japim fjalën pastaj e hapim diskutimin;

**zpj. Dardana Tafili-Dauti:** Plani i integritetit është dokument strategjik dhe operativ që konsiderohet mjet i rëndësishëm për integritetin institucional. Ka për qëllim respektimin e drejtpërdrejtë të vlerave morale, standardeve profesionale dhe rregullave të zbatueshme normative. Ky plan ka kaluar nëpër 4 fazë; faza përgatitore, vlerësimit të rezikut, përcaktimit të prioriteteve dhe propozimin e mostrave dhe fazën e raportimit dhe monitorimit. Metodat të cilat janë përdorur janë pyetësorët. Ky plan ka vlefshmëri në afat 4 vjeçar. Në rast së koordinatori e vlerëson së mostrat e parapara në këtë plan nuk po jepin rezultate, atëherë mundet të formulohet plani i ri. Fushat e rezikut të përgjegjshme dhe ato specifike janë të qartësuara në planin përkatës. Ne kemi formuar një grup punues-hartues të këtij plani, pastaj është caktuar koordinatori i cili merret me monitorim dhe zbatim të këtij plani.

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin e kësaj pike:

**z. Agim Mani:** Komisioni i cili e ka hartuar këtë plan, a është funksional ende apo jo? 2. Koordinatori i raporton kryetarit, ndërkaq kryetari atë raport e sjellë në KK si informatë. Si plan është i mirë nëse realizohet, se këtë po e themi duke u bazuar në përvojat e kaluara.

**zpj. Dardana Tafili-Dauti:** Grupi punues (GP) i këtij plani ka qenë i përbërë prej 5 personave. GP e ka kryer punën e vet dhe nuk ka më asnjë obligim ndaj këtij plani, d.m.th grupit punues i ka përfunduar mandati.

**z. Adnan Reka:** Plani i integritetit i ngjason shumë planit të banimit. Edhe në të kaluarën kemi pasur plan të integritetit, nuk kemi qenë dhe aq të kënaqur me realizimin e tij. Plani është i ngjashëm me atë paraprak, mirëpo realizimi mbetet për të dëshiruar.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ne kur të hartojmë draft strategji, rregullore, plane dhe kur të diskutojmë për to, është mirë të fokusohemi në përbajtjen e tyre. Plani ka ardhur në KK, mund të ketë ndonjë lëshim që mund të përmirësohet, ndërkaq çështja e realizimit mund të

epén vërejtje kur t' vjen raporti në KK nga kryetari i komunës. Plane, raportet rregulloret duhet diskutohen, të plotësohen nëse kanë ndonjë lëshim në përbajtje dhe të votohen.

**z. Adnan Reka:** Unë nuk e quaj gabim nëse ti kryesues e merr fjalën për diskutim, ndërkaq pas çdo diskutimi ju na jepni përgjigje, ajo është gabimi kryesor. I dhanë sqarimet e nevojshme në këto plane drejtori dhe drejtoresha, ndërkaq ju sa herë po dilni në mbrojtje të projekteve e planeve. Merre fjalën dhe fol si anëtari KK, e jo me i mbrojtur planet.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Si anëtar i KK po flas, po ti nuk bëre asnjë pyetje lidhur me planin, ti e jepe një mendim me paragjykim, kështu unë diskutova rreth këtij diskutimi. Mundet mos me të pëlqyer diskutimi im, unë nuk jam i mendimit me paragjykuar.

**z. Agim Mani:** Nuk është paragjykim kjo, plani i integritetit ndahet në fazë, mirëpo nuk janë caktuar koha e realizimit të tyre. Nëse ju nuk precizoni me kohë realizimin e planit, kjo na bënë mos me besuar.

**z. Agim Çaka:** Unë e kam një propozim për dy kolegët këtu; Kur t'na adresohet ndonjë plan apo propozim, atëherë ne duhet me u marrë me pikat e atij plan programi se a janë në rregull apo jo, a duhet me shtuar apo me hequr diçka. Unë nuk e di drejtoresha sesa mundet me realizuar këtë plan të cilin na e paraqet këtu, megjithatë diskutimet tona duhet me qenë konstruktive. Nëse vjen koha që drejtoresha pas një kohe të caktuar del me një raport për realizimin e planit të paraqitur, atëherë mundemi me diskutuar sesa iu ka përbajtur këtij plani, sa % ka arritur me realizuar planin e kështu me radhë. Ne jo vetëm për këtë plan, por për të gjitha planet të cilat na paraqiten këtu, është mirë në esencë me diskutuar për të së a ka diçka që nuk funksionon brenda planit të propozuar.

**znj. Dardana Tafili-Dauti:** Në pyetjen e Agimit kur foli për fazat, fazat janë zhvilluar, përndryshe nëse nuk i kishim kaluar këto faza, atëherë nuk ishte hartuar ky plan.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 18 votë Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 8 anëtarët nga LVV. Prezentë në mbledhje kur u votua kjo pikë ishin 26 anëtarë, pasi që anëtari nga LDK-Betim Shala nuk ishte në sallë kur u votua kjo çështje. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Me të cilin e Aprovoj Planin komunal për integritet për vitet 2022-2026 / Lënda: 01Nr. 104/02-13273/22.**

5. Propozim-Vendimi për ndryshimin e thirrjes, Shkolla e Mesme Profesionale –ShMP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”, në Institucion i Arsimit dhe Aftësimit Profesional - IAAP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Materialin e keni marrë, drejtori është prezantë në mbledhje, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Kur u votua kjo pikë, prezantë ishin 27 anëtarë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për ndryshimin e thirrjes, Shkolla e Mesme Profesionale –ShMP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”, në Institucion i Arsimit dhe Aftësimit Profesional - IAAP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” / Lënda: 01Nr. 04-610/01-12903/22.**

6. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m<sup>2</sup> në parcelën kadastrale 00255-3 zona kadastrale Vatë-Dubravë, me kulturë bujqësore Arë e klasës 5, në emër të Xhevxhet (Ahmet) Mema nga f. Dubravë;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Materialin e keni marrë, drejtori është këtu, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjtë u aprovua me 17 votë Për (12 PDK, 2 AAK, 2 LVV – Raif Kasa dhe Naim Beça, 1 NISMA), Kundër votë nuk pati, Abstenuan 9 anëtarë (4 nga LDK, 5 nga LVV) Prezentë kur u votua kjo pikë ishin 26 anëtarë, pasi që nuk ishte prezentë anëtarja nga LVV- Arta Avdiu. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m<sup>2</sup> në parcelën kadastrale 00255-3 zona kadastrale Vatë-Dubravë, me kulturë bujqësore Arë e klasës 5, në emër të Xhevxhet (Ahmet) Mema nga f. Dubravë / 01Nr. 06-350/02-11204/22.

7. Propozim Vendimi për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m<sup>2</sup> në parcelën kadastrale 00311-0 zona kadastrale Ivajë, me kulturë bujqësore Livadh i klasës së 6, pronë e Samedin (Vehbi) Rexha nga Kaçaniku;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Materialin e keni marrë, drejtori është këtu, besoj se janë përmirësuar gabimet që kanë qenë në draftin e mbledhjes se kaluar. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Agim Çaka:** Kërkoj nga drejtori i DBPZHR që të ruaj fondin e tokave bujqësore, për shkak së tokat bujqësore janë të rrezikuar burkur shumë, ndërkaq dihet se fondi i tokave bujqësore në komunën tonë është shumë i vogël.

**z. Adnan Reka:** Ata që i dinë rreziqe, është mirë me qenë kundër, e ne që nuk i dimë rreziqet, zakonisht abstenojmë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjtë u aprovua me 20 votë Për (12 PDK, 4 LDK, 2 AAK, 1 NISMA, 1 LVV-Raif Kasa), Kundër votë nuk pati, Abstenuan 6 anëtarë nga LVV. Prezentë në mbledhje kur u votua kjo pikë ishin 26 anëtarë, nuk ishte prezentë Arta Avdiu nga LVV. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të sipërfaqes 300m<sup>2</sup> në parcelën kadastrale 00311-0 zona kadastrale Ivajë, me kulturë bujqësore Livadh i klasës së 6, pronë e Samedin (Vehbi) Rexha nga Kaçaniku/ Lënda: 01Nr. 06-350/02-6286/22.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu që Kryesuesi i Kuvendit Kemal Murseli e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora 12:02. Deri në fund të mbledhjes ishin 26 anëtarë, ndërkaq Arta Avdiu. me leje doli me herët nga mbledhja.

Procesmbajtës  
Makfire Malsju  
*Malsju*



**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS**  
**(të zgjedhur në votimet e datës 17 Tetorit 2021);**

**Nga Mbledhja e V (pestë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2022, mbajtur me 31.05.2022:**

1. Kemal Murseli .....,
2. Brahim Imishti.....,.....,
3. Hamide Luma .....,.....,
4. Kadri Krivenjeva .....,.....,
5. Fitore Vishi,.....,.....,
6. Rrustem Zenuni,.....,.....,
7. Edon Baftiu .....,.....,.....,
8. Selajdin Troni .....,.....,.....,
9. Fatmir Bunjaku .....,.....,.....,
10. Bashkim Krasniqi .....,.....,.....,
11. Florina Lika-Vishi .....,.....,.....,
12. Lejla Muhamheri-Çaka.....,.....,
13. Agim Mani .....,.....,.....,
14. Kadrije Lika-Troni .....,.....,.....,
15. Adnan Reka .....,.....,.....,
16. Naim Beça .....,.....,.....,
17. Raif Kasa .....,.....,.....,
18. Ernesta Krasniqi,.....,.....,
19. Bashkim Luma .....,.....,.....,
20. Arta Avdiu .....,.....,.....,
21. Ardita Rrahmani .....,.....,.....,
22. Besnik Salihu .....,.....,.....,
23. Betim Shala,.....,.....,
24. Arlinda Rakoci-Raka.....,.....,.....,
25. Rabije Sallahi.....,.....,.....,
26. Ekrem Livoreka.....,.....,.....,
27. Agim Çaka.....,.....,.....,



## Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 27.06. 2022

Për: Anëtarët e Kuvendit:

znj. Ardita Rrahmani,  
z. Naim Beça,  
z. Agim Çaka

### Lënda: PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruara para Kuvendit të Komunës, më datë 31. 05. 2022, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.

**znj. Ardita Rrahmani:** Rruga “Malsor Dashi” është rrugë mjaft e qarkulluar- rrugë lidhëse mes Kaçanikut dhe f. Stagovë, e cila rrugë na dërgon të varrezat e reja të qytetit. Kjo rrugë përpos mungesës së trotuarit, ka edhe mungesë të ndriçimit publik. Qarkullimi në atë pjesë sidomos në sezonin e verës është shumë i konsiderueshëm, ku edhe një numër i madh i qytetarëve e shohin atë pjesë të qytetit si mundësi e mirë për rekreacion dhe ecje. Deri kur ajo pjesë e qytetit do të jetë në atë gjendje dhe a keni menduar me marrë veprime të nevojshme për rregullimin e ndriçimit publik dhe të trotuarit të asaj rruge?

- *Rruga “Malsor Dashi” është një nyje shumë e rëndësishme për lidhje të qytetit me pjesën periferike deri te stadioni i qytetit. Është menduar për ndërtim të trotuarit, ndriçimit publik dhe shtegut për çiklizëm. Kjo rrugë në segmente të caktuara ka gjërë të pamjافتueshme dhe atakon prona private. Kjo e veshitirëson trasimin e trotuarit dhe shtegut për çiklizëm. Po të ekzistonte gatishmëria e pronarëve për të lëshuar pjesën e pronës për zgjërim të trases së rrugës ky projekt do të realizohet shumë shpejtë.*

**z. Naim Beça:** Çështja e rrugëve në Kaçanik, është bërë bajat kjo punë, prej shtatorit të vitit 2021 nuk mundesh me bërë një shëtitje nëpër qendër të qytetit të Kaçanikut. Para xhamisë, kockat-kubzat janë hapur, tanë besoj se do të hapen edhe më tepër, është krijuar një gropë e madhe, jam i bindur se brenda javës ka me pasur edhe me tepër prishje të kubzave në atë pjesë. Kërkoj me intervenuar në çështjen e rregullimit - mbulimit të asaj grope. Po ashtu para barnatores të Ura e Hazirit, është krijuar një gropë shumë e madhe. Njerëzit me vullnet të mirë po e mbulojnë atë gropë me paletë. Kjo rrugë është e frekuentuar, ndërkaq nuk kushton shumë mbulimi i asaj grope.

- *Projekti “Reabilitimi i rrugës “Qamil Ilazi” dhe “Sali Bajra” është në fazën e finalizimit. Janë duke u bërë sanitimet e kërkua nga menaxheri i kontratës. Kurse rreth mirëmbajtjes së rrugëve lokale, nga kompania e kontraktuar, këtë javë do të fillohet me sanitimin e gropave me shtresë asfalti në zonën urbane dhe rurale.*

**z.Agim Çaka:** Kam një pyetje lidhur me kioskat ambulatore që po vendosen në bulevard. A ka ndonjë projekt komuna, apo kujt ti teket me vendosur aty kioskë pa ma parasysh formën, hapësirën, biznesin të cilin e zhvillon aty ? Mendoj se komuna duhet me pasur një projekt dhe ku mund të vendosen kioskat. Kjo kishte me qenë mirë për syrin e qytetarëve renditja e tyre për pamjen, për dukjen dhe për sy të qytetarëve dhe për bizneset që zhvillohen aty, e jo me u vendosur kioske në formë të çrregullt, por me rend dhe rregull. Pyetja është; A ka projekt komuna, sa kioske do të vendosen në total, hapësirat e vendosjes se tyre në bulevard, apo vendosen në bazë të kërkesave që parashtrohen, se pastaj ajo formë bien keq në sy të qytetarëve dhe lind nevoja për heqjen e tyre ?

- *Komuna e Kaçanikut, përmes projektit “Reabilitimi i dy shetitoreve përgjatë lumit Nerodime”-projekt që do te filloj me fazën e parë këtë vit, ka të planifikuara rregullimin e lokacioneve të caktuara për vendosjen e kiosqeve përgjate bulevardit “Ismail Raka”. Do të punohen lokacione të përshtatshme në distancë të caktuara dhe infrastrukturën përcjellëse (rryma, uji , kanalizimi).*


*Kioskat aktuale kanë pëlqim të perkohshëm nga drejtoria bazuar në veprimtarinë që është aprovuar nga komisioni komunal (akulloreshitës, fast-food, etj).*

**z. Naim Beça:** Shprehi shqetësimin e qytetarëve të komunës për çështjen e resheteve në rrugë, të cilat me rastin e kalimit të veturave, janë shumë të zhurmshme,, e ne veçanti në orët e vonshme të natës. Qytetarët me janë lutur me biseduar me kryetarin për këtë çështje. Problemi është të rruga përpjetë kah Rakoci, pastaj në rrugën Nexhmush Elezi. Është kërkesë e qytetarëve, i kam edhe nënshkrimet e qytetarëve, me rregulluar këtë çështje, se është shumë problem i madh, me çka mund të ketë edhe pasoja.

- *Përmes kompanisë për mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe kompanisë për mirëmbajtjen e kanalizimit fekal dhe atmosferik, në vazhdimësi bëjmë rregullimin e kapakëve të pusetavë, reshetskave të ujrate atmosferik, etj. Do të intervenohet edhe në rr. “Nexhmush Elezi” në sanimin e reshetskës së dëmtuar.*

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,

  
Ramadush Osmani  
Drejtëor i DSHPE-së